



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 93-të, të mbajtur më 29.09.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-3442/1 nga 14.07.2023 , i cili i referohet të dhënave të kërkuesit se si DHPGJS-ja duhet të veprojë në disa raste specifike. **HIDHET POSHT**

KSHPK-ja konstatoi se, sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë, sepse nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencat publike dhe detyrat zyrtare.

Lënda me numër 12-3442/1 nga 14.07.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 14.07.2023, një kërkues i njohur ka dorëzuar denoncim që i referohet treguesit të parashtruesit se si KSHPK-ja duhet të veprojë në disa raste specifike dhe është formuar lënda me numër 12-3442/1 të datës 14.07.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se si duhet të veprojë KSHPK-ja në situatat kur një dokument i caktuar dëshmuës tashmë është përcjellë tek organet gjyqësore me rastin e konstatimit të veprës penale, tregimit të mëtejshëm të veprimit në rast presioni politik, monitorimit të qarkullimit të parave, etj.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se në këtë rast nuk ka pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent. për rastin në fjalë

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: Mr. SH:S

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

